



VLORE
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA IMAZHET SATELITORE 2025


Finalizohet “Mbulesa e Tokës 2024” për të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë

ASIG ka përfunduar me sukses prodhimin dhe publikimin e hartës digjitale interaktive tematike “Mbulesa e Tokës 2024”, një projekt inovativ që shënon një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit më efikas dhe të qëndrueshëm të territorit në Republikën e Shqipërisë.

Harta mbulon të gjithë territorin kombëtar, të ndarë sipas Njësive të Qeverisjes Vendore, dhe ofron informacion të detajuar mbi mbulesën dhe karakteristikat e sipërfaqes tokësore, duke përfshirë zonat urbane, pyjet, sipërfaqet ujore, tokat bujqësore dhe serrat.


Ndërtuar në platformën ArcGIS Online, kjo hartë tematike ofron akses të menjëhershëm dhe të lehtësuar për institucionet publike, duke shërbyer si një instrument i rëndësishëm për planifikimin hapësinor, menaxhimin e burimeve natyrore dhe monitorimin e ndryshimeve mjedisore në nivel kombëtar dhe vendor.

Për më shumë informacion, vizitoni [dashboard-in](#).



Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Informacion Gjeohapësinor për temën: “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”




ASIG, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si autoritet publik përgjegjës për temën “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”, ka përditësuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën gjeohapësinore “Institucionet Arsimore”. Kjo shtresë përmban informacion të detajuar mbi: Shkollat 9-vjeçare; Shkollat e mesme; Universitetet; Drejtoritë Arsimore dhe Kopshtet në rang kombëtar.

Këto të dhëna janë përpunuar dhe publikuar në përputhje me standardin shtetëror për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri, të miratuar me VKM nr. 998, datë 09.12.2020.

Informacion Gjeohapësinor për temën: “Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Poligon)”

ASIG në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën “Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Poligon)”. Kjo shtresë përfshin qendrat historike dhe zonat përreth tyre, zonat arkeologjike të kategorizuara sipas tipologjisë “A” dhe “B”, bazuar në intensitetin e gjurmëve arkeologjike, si dhe zonat e mbrojtura të monumenteve të veçanta.

Të dhënat janë përgatitur në përputhje me standardin shtetëror për temën “Zonat e mbrojtura”, të miratuar me VKM nr. 891, datë 18.11.2020.



Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara për akset rrugore kombëtare dhe urbane, ASIG ka përdorur teknologjinë e avancuar Street View 360°. Në këtë kuadër, është realizuar fotografimi i “Rrugëve urbane të qytetit të Korçës”, me një mbulim prej 110 km, si dhe i “Rrugëve urbane të qytetit të Përmetit”, me një gjatësi prej 30 km.

Të dhënat vizuale janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar duke ofruar një panoramë të detajuar të infrastrukturës rrugore në këto qytete. Ky informacion përbën një mjet të rëndësishëm mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane – Korçë




Rrugë Urbane – Përmet

Rilevim me teknologjinë UAV - Zona Shëngjin

ASIG realizoi rilevimin fotogrametrik të zonës urbane të Njesisë Administrative Shëngjin përmes përdorimit të teknologjisë UAV (Unmanned Aerial Vehicle). Ky rilevim mbulon një sipërfaqe prej 8.2 km² me rezolucion prej 4cm, duke mundësuar prodhimin e ortofotos, modelit digjital të sipërfaqes (DSM), modelit digjital të terrenit (DTM) dhe izoipseve. Të dhënat e krijuara do të shërbejnë si bazë për planifikim urban, menaxhim territori dhe vendimmarrje të bazuar në informacion të saktë gjeohapësinor.



Ortofoto



Modeli Digjital i Terrenit

Zgjerimi i Hartës Bazë – Fshatrat Hotovë, Mokricë, Gosnisht, Kosovë (Përmet)



ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për fshatrat Hotovë, Mokricë, Gosnisht, Kosovë të bashkisë Përmet. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 4.2 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.

PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

ASIG merr pjesë në workshop-in “Njohuritë e hapësirës për mundësi të reja biznesi”

Më 17 korrik 2025, përfaqësues të ASIG morën pjesë në workshop-in me temë “Njohuritë e hapësirës për mundësi të reja biznesi”, organizuar në Bari, të Italisë, në kuadër të projektit SOFTMOVE. ASIG prezantoi përvojën në monitorimin e territorit përmes teknologjive hapësinore, me përdorim në menaxhimin mjedisor, emergjencat civile, fatkeqësitë natyrore dhe planifikimin hapësinor. Diskutimet theksuan përdorimin e teknologjive hapësinore për sistemet ajrore autonome dhe modelet e reja të biznesit në zonën ndërkufitare IPA.



ASIG finalizon projektin SOFTMOVE dhe zyrtarizon bashkëpunimin ndërkufitar për teknologjitë UAS



ASIG finalizoi me sukses pjesëmarrjen në projektin SOFTMOVE, në Konferencën Përfundimtare të mbajtur më 29 korrik 2025 në Bari, të Italisë, organizuar nga Scarl Distretto Tecnologico Aerospaziale (DTA). Krahas prezantimit të arritjeve dhe kontributeve të partnerëve, konferenca shënoi edhe nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet ASIG, DTA dhe Digital Den për zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve UAS në nivel ndërkufitar. Ky aktivitet u shoqërua me sesione interaktive ndërmjet industrisë dhe akademisë, ku Shqipëria u përfaqësua nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe kompania Geosensors.

Takim ndërinstitucional ndërmjet ASIG dhe Departamentit të Gjeografisë, të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë

Në kuadër të marrëveshjes ndërinstitucionale, më 1 korrik 2025, ASIG zhvilloi një takim me drejtues dhe staf akademik të Departamentit të Gjeografisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e informacionit gjeohapësinor. Partneriteti ka kontribuar në avancimin e arsimit dhe kërkimit shkencor, duke fuqizuar kapacitetet akademike dhe teknologjike në këtë fushë.

Ky bashkëpunim i qëndrueshëm mbështet zhvillimin e trajnimeve, aksesin në platforma të avancuara dhe realizimin e projekteve të përbashkëta që promovojnë përdorimin praktik të teknologjive GIS, Remote Sensing dhe UAV në mjedisin akademik dhe institucional.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Sistemet GNSS funksionale edhe në Hënë – sukses historik për Galileo dhe GPS

Për herë të parë, një marrës GNSS (Global Navigation Satellite System) ka kapur dhe përpunuar me sukses sinjalet nga Galileo dhe GPS, duke ofruar pozicionim të saktë në orbitë dhe mbi sipërfaqen e Hënës. Ky sukses u arrit nga eksperimenti LuGRE (Lunar GNSS Receiver Experiment), pjesë e misionit Blue Ghost 1, ku pas uljes në Hënë marrësi GNSS u aktivizua dhe përlloragiti për herë të parë një pozicion satelitor në sipërfaqen e saj. Ky zhvillim konfirmon se sistemet ekzistuese GNSS mund të mbështesin eksplorimin e Hënës dhe misionet e ardhshme automatike, duke ofruar mundësi të reja për aplikime shkencore dhe teknologjike përtej Tokës.

Sentinel-5A përforcon kapacitetet evropiane për monitorimin e atmosferës

Në muajin gusht 2025, pritet lëshimi i instrumentit Sentinel-5A, që do të forcojë ndjeshëm kapacitetet e Bashkimit Evropian për monitorimin e atmosferës. Ky instrument, pjesë e programit Copernicus, do të sigurojë të dhëna ditore me rezolucion të lartë për ndotësit e ajrit dhe përbërësit kryesorë atmosferikë si: dioksidi i azotit, ozoni, monoksidi i karbonit dhe metani. Të dhënat do të mbështesin politikën evropiane për ndotjen zero dhe parashikimet e shërbimit Copernicus për Monitorimin e Atmosferës (Copernicus Atmosphere Monitoring Service - CAMS), duke kontribuar në vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

AKTIVITETE NË VIJIM

ICSIGG 2025

Më 20 gusht 2025, në Bitolë të Maqedonisë së Veriut, do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare për Imazherinë Satelitore dhe Gjeografinë GIS. Ky aktivitet do të mbledhë profesionistë dhe studiues nga e gjithë bota për të shkëmbyer ide, përvoja dhe rezultate kërkimore në fushën e imazherisë satelitore dhe GIS-it duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e teknologjive inovative për analizën dhe përdorimin e të dhënave.

20 Gusht 2025

EFGS 2025

Shoqata Evropiane e Gjeostatistikës organizon nga 23–25 shtator 2025, në Oslo, të Norvegjisë, Konferencën Evropiane për Gjeostatistikën dhe të Dhënat Hapësinore. Ky aktivitet synon të fuqizojë përdorimin e të dhënave hapësinore të besueshme për vendimmarrje duke prezantuar zgjidhje të avancuara në fushën e gjeostatistikës dhe analizave hapësinore.

23 - 25 Shtator 2025

INTERGEO 2025

Nga data 7 – 9 tetor 2025, në Frankfurt, të Gjermanisë, do të zhvillohet panairi ndërkombëtar INTERGEO 2025, aktivitet i mjaft i rëndësishëm për gjeodezinë, informacionin gjeohapësinor dhe menaxhimin e tokës. Panairi do të mbledhë ekspertë dhe institucione nga fusha si: GIS, fotogrametria, sensorët në distancë, dronët dhe qytetet inteligjente, duke promovuar zgjidhje për sfidat globale si ndryshimet klimatike dhe urbanizimi i qëndrueshëm.

7 - 9 Tetor 2025